



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 9, datë 29.05.2023

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin maj, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:17

Data e mbajtjes së mbledhjes : 29.05.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin maj të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë projektvendim të propozuar nga kryetarja e bashkisë. Do kemi gjithashtu dhe informim nga kryetarja e Komisionit të Mjedisit. I gjithë dokumentacioni ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretaria e Këshillit. Ftoj sekretaren të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

Gjithsej 32 këshilltar në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MAJ 2023
Pika 2. Informim Këshilltarëve	INFORMIM MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE SITUATËN MJEDISORE NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS.

Atëherë kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?... Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës dhe vendosi ta kaloj me vota unanime. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, ka?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?...Nuk ka.

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në **pikën 2** dhe ftoj të relatoj këshilltaren Morena Boja.

Morena Boja : Faleminderit.

Të nderuar pjesmarrës !

Materaili për të cilin unë do të referoj paraqet një përshkrim mbi ndryshimet klimatike. Informacioni ndahet në tre pjesë. Pjesa e parë është një përshkrim mbi ndryshiet klimatike në të gjithë vëndin, pjesa e dytë i referohet zonës bregdetare ku bën pjesë dhe Durrësi dhe pjesa e fundit ka të bëj me mbetjet duke qënë se në të gjitha raportet jo vetëm të Komisionit European, por dhe në raporte të tjera konsiderohet si nja nga faktorët që ndikon në ndryshimet klimatike.

Shqipëria është një nga vendet më të cënuara në rajon për sa i përket tendencave të ndryshimeve klimatike. Modelet e ndryshimit të motit gjatë 15 viteve të fundit kanë sjell në rajon rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe ngjarje ekstreme më të shpeshta si përmytjet dhe thatësitat. Parashikimet për klimën në vitin 2050 përfshijnë rritje të mëtejshme të temperaturës, rritje të nivelit të detit dhe më shumë reshje që bien si episode të shiut intensiv në vend të borës.

Bregdeti ynë po ngrohet 20 % më shpejt se pjesa tjetër e globit dhe ne jemi një nga vendet më të goditura nga erozioni bregdetar në Evropë. Masat e zbutjes, përshtatjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të përshkruara në raportin dyvjeçar të përditësimit demonstroi që angazhimi i vazhdueshëm nga Qeveria Shqiptare për përfshirjen e ndryshimeve klimatike është tepër i lartë, sidomos në fusha dhe sektorë kyç.

Për sa i përket raporteve ndërkombëtare rezulton se në përgjithësi, sektorët global që kontribuojnë në ngrohjen më të madhe në terma afatshkurtër kohore së pari janë burimet e dominuara nga metani, p.sh, prodhimi i energjisë (miniera, karburante fosile dhe shpërndarja), bujqësia dhe menaxhimi i mbetjeve.

Për sa i përket përshkrimit mbi impaktin e ndryshimeve klimatike në zonat bregdetare ku bën pjesë dhe Durrësi problematika më e evidentuar është fakti që ka një ndërtim pa kriter ç'ka e bën të vështirë planifikimin mbi urbanistikën dhe zhvillimin e vijës bregdetare. Ndikimet klimatike pritet të ndikojnë pjesën më të madhe të popullsisë rreth 97% që jeton brenda 100 km nga bregu detar dhe zhvillimi urban i parregulluar në vija bregdetare pengon infrastrukturën për të ardhmen gjithashtu ekspozimin më të lartë të popullsisë ndaj dëmeve që mund të vinë në të ardhmen nga ngritja e nivelit të detit.

Elementi i tretë që përmendet është roli i menaxhimit të mbetjeve në ndryshimet klimatike. Menaxhimi i mbetjeve ka të paktën pesë lloje ndikimesh në ndryshimet klimatike, që i atribuohen: (1) emëtimeve të metanit në landfill; (2) reduktimi i përdorimit të energjisë industriale dhe emëtimeve për shkak të riciklimit dhe reduktimit të mbetjeve; (3) rikuperimi i energjisë nga mbeturinat; (4) sekuestrimi i karbonit në pyje për shkak të uljes së kërkesës për letër të pastër; si dhe energjia e përdorur në transportin e mbetjeve në distanca të gjata të tyre.

Për sa i përket disa rekomandimeve Qeveria Shqiptare e ka konsideruar çështjen e mbetjeve si një ndër gjatë prioriteteve të saj, duke i dhënë rëndësi të madhe trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve dhe duke vlerësuar që çdo njësi e vetqeverisjes vendore të ketë një vend të licensuar dhe me parametrat mjedisore për të depozituar mbetjet e tyre. Gjithashtu një sugjerim është që administrata e bashkisë, të monitorojë dhe të paraqes raporte në këshillin bashkiak mbi ecurinë e këtyre problematikave të cilat u përmendën më sipër.

Kaq ishte materiali. Është vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit.

Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Boja.

Për sa i përket informimit nëse ka ndonjë pyetje?

Atëherë nuk ka pyetje.

Znj. Kryetare.....

Emiriana Sako : Meqenëse besoj se kjo do jetë mbledhja e fundit deri në konstituimin e këshillit të ri dua të bëj një falenderim për të gjithë punën që ka bërë këshilli bashkiak në këtë mandat, i cili ka patur një vështirësi të madhe dhe specifike për pasojat që solli tërmeti në qytetin e Durrësit. Mendoj që ka qënë një hallkë kyçe në realizimin e programit të rindërtimit dhe sigurisht që ka qënë një mbështetje e madhe për punën që ka bërë bashkia e Durrësit në këto vite plot sfida. Kështu që dua t’ju falenderoj dhe t’ju uroj suksese atyre që janë pjesë në këshillin e ri, duke shpresuar që ky madat, që do t’nisi do të jetë një mandat shumë i rëndësishëm për qytetin e Durrësit për të filluar punën për projekte transformuese që kemi së bashku.
Faleminderit të gjithëve.

Ani Dyrmishi : Faleminderit kryetare.

Edhe unë dua të falenderoj të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak që kanë ushtruar funksionin e këshilltarit në këtë legjislaturë. Besoj se e kam patur nder të drejtoj këtë këshill me pjesmarrje nga të gjitha fushat. I uroj suksese anëtarëve që janë rizgjedhur dhe anëtarëve të tjerë i uroj suksese në fushat ku ushtrojnë profesionin e tyre.
Faleminderit të gjithëve.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 4 (katër) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores së Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ (*mungon*)

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Përfaqësues i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI